

01/09/2023.

**STATUTI**  
**I**  
**SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR**  
**"English Zone" SH.P.K.**

**KREU I**  
**HYRJE**

**Neni 1**

Shoqëria me përgjegjësi të kufizuar "English Zone" sh.p.k është themeluar nga ortaku i vetëm:

**Paul Tobiloba Olaoye**, atësia Late Olaoye Solomon, datëlindja 05.12.1995, lindur Ibanan Nigeri dhe banues në adresën: Road D7, Tinubu Layout, Oyediji Iwo Road – Ibanan, OYO State, Nigeri, mbajtës i dokumentit të identitetit të shtetit të Republikës së Nigerisë, Pasaporta me nr. B00533870.

Themeluesit, të cilët janë madhorë, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, në përputhje me ligjin hartojnë edhe statutin e Shoqërisë si më poshtë:

**KREU II**  
**PERKUFIZIME**

**Neni 2**

**Emertimi i shoqërisë**

Emertimi i shoqërisë është "English Zone" sh.p.k

**Neni 3**

Asambleja e ortakëve ka vendosur miratimin e statudit të shoqërisë në bazë të legjislacionit në fuqi të Republikës së Shqipërisë, vecanerisht sipas ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008, "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" të ndryshuar, dhe si person juridik, e zhvillon aktivitetin në përputhje me këtë legjislacion dhe me normat e këtij statuti. Ky statut hyn në fuqi pas regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit. Gjithashtu shoqëria e bazon aktivitetin e saj në ligjin nr. 9121, datë 28.7.2003 "Për Mbrojtjen e Konkurrencës" të ndryshuar, në Kodin Civil dhe Kodin e Punes si dhe në ligje të tjera në Republikën e Shqipërisë.

**Neni 4**

**Forma**

Shoqëria "English Zone" sh.p.k është "Shoqëri me Përgjegjësi të kufizuar" Sh.p.k.



## **Neni 5**

### **Selia**

1. Selia e Shoqërisë ndodhet në Qytetin e Tiranës në adresën: Bulevardi Bajram Curri, pallati nr. 105, Hyrja 3, kati 2, ap. 5, Tiranë.
2. Shoqeria ka te drejte te hapi filiale te tjera brenda territorit te Republikes se Shqiperise ne varesi te selise Qendrore qe ndodhet ne qytetin e Tiranës.
3. Vendi i mbajtjes se mbledhjeve te asamblese se pergjithshme eshte selia e shoqerise. Nese bihet dakord me unanimitet mbledhjet e asamblese mund te kryhen ne nje vend tjeter.

## **Neni 6**

### **Objekti i veprimtarise se shoqerise**

Objekti i veprimtarisë së Shoqërisë do të jetë:

- Ofrimi i shërbimeve te kurseve ne gjuhen Angleze, pergatitje e nxenesve dhe trajnime te studenteve per provimet e gjuhes Angleze si IELTS, TOFL, TOIC Etj.

Si dhe çdo veprimtari tjetër ekonomike që do të konsiderohet e nevojshme dhe e dobishme për realizimin e qëllimit të shoqërisë dhe që nuk bie ndesh me legjislacionin Shqiptar në fuqi.

## **Neni 7**

### **Vula e shoqerise**

1. Shoqeria ka vulen e saj, ne brendesi te se ciles shkruhet i plote emertimi i shoqerise dhe forma e saj juridike.
2. Te gjitha aktet qe dalin nga shoqeria, pasi nenshkruhen sipas ligjit, vulosen me vulen e shoqerise.

## **Neni 8**

### **Kohezgjatja e shoqerise**

Kohezgjatja e shoqërisë do të jetë e pakufizuar dhe fillon nga momenti i regjistrimit të saj në Qendrën Kombëtare të Bizneseve me përjashtim të rasteve kur mbaron sipas parashikimeve në ligj ose kur vendos Asambleja e Pergjithshme.

## **Neni 9**


### **Veprimet e lejuara te shoqerise**

Shoqeria mund te ndryshoje emertimin, seline, kohezgjatjen dhe objektin e veprimtarise se saj sipas vendimeve qe do te marre Asambleja e Pergjithshme me shumicen e ortakëve që përfaqësojnë të paktën  $\frac{3}{4}$  e pjeseve te kapitalit.

## **Neni 10**

### **Marredheniet e punes**

1. Shoqeria per te kryer veprimtarine e saj sipas objektit te ketij statuti do te lidhe kontrata individuale per te rregulluar marredheniet e punes.



2. Kontratat e punes do te lidhen konform ligjit "Kodi i Punes së Republikës së Shqiperise" dhe dispozitave te tjera ligjore qe rregullojne marrredheniet e punes ne Republiken e Shqiperise.

### KREU III

#### PARIMI I DETYRIMIT TE BESNIKERISE

##### Neni 11

###### Ndalimi, konflikti i interesit dhe personat e lidhur

1. Personi i autorizuar per te perfaqesuar ose mbikqyrur shoqerine tregtare nuk mund te lidhe kontrata apo te hyje ne marrredhenie te tjera me shoqerine tregtare, nese nuk deklarohen kushtet e veprimit, si dhe natyren e objektin e interesit te tij e veprimi nuk autorizohet paraprakisht prej te gjithe ortakeve ose te gjithe ortakeve te tjere.
2. Cdo miratim paraprak dhe i pergjithshem njoftohet per regjistrim ne Qendren Kombetare te Regjistrimit.
3. Miratimi i parashikuar jepet, gjithashtu, per çdo kontratë apo marrëdhënie tjetër, që shoqëria lidh me një palë të tretë, e cila ka marrëdhënie personale apo financiare me personat e autorizuar për të përfaqësuar ose për të mbikëqyrur shoqërinë, apo me palë të treta, marrëdhëniet e të cilave me personat e mësipërm janë të tilla që, në mënyrë të arsyeshme, mund të ndikojnë vendimmarrjen e tyre në kundërshtim me interesat e shoqërisë. Personat në vijim prezumohen të kenë një apo më shumë nga interesat e mësipërm me personat e autorizuar për të përfaqësuar ose për të mbikëqyrur shoqërinë:
  - a) bashkëshorti/bashkëshortja, prindërit, vëllezërit ose motrat e bashkëshortit/bashkëshortes;
  - b) fëmijët, prindërit, vëllezërit, motrat, fëmijët e fëmijëve ose bashkëshorti/bashkëshortja e personave të mësipërm;
  - c) personat e lidhur me personin e autorizuar për të përfaqësuar ose për të mbikëqyrur shoqërinë. Persona të lidhur janë: të paralindurit apo të paslindurit, të afërmit në vijë të tërthortë të shkallës së dytë, birësuesi ose i birësuari, i afërmi i shkallës së parë i bashkëshortit/bashkëshortes;
  - d) një person, që banon me personin e autorizuar për të përfaqësuar ose për të mbikëqyrur shoqërinë.
4. Personat, të cilët kërkojnë miratim për një transaksion, sipas pikave 2 e 3 të këtij neni, nuk mund të marrin pjesë në votimin për miratimin e veprimit e nuk llogariten në kuorum.
5. Çdo veprim që kërkon miratim, sipas pikave 2 dhe 3 të këtij neni, publikohet në pasqyrat financiare dhe raportet e ecurisë së veprimtarisë, së bashku me kushtet e veprimit, si dhe natyrën e objektin e interesit të personave të përfshirë.
6. Per efekt te ketij statuti, me persona te autorizuar per te perfaqesuar ose mbikqyrur shoqerine tregtare do te kuptojme ortaket e shoqerise, administratorin, ekspertin kontabel te autorizuar dhe likuiduesin e shoqerise.

## Neni 12

### Parimi i besnikerise

1. Gjatë ushtrimit të të drejtave, ortakët veprojnë, duke marrë parasysh interesat e shoqërisë dhe të ortakëve të tjerë. I njëjti detyrim zbatohet edhe për administratorët.
2. Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në ligj ose nga ky statut, në rrethana të njëjta, ortakët gëzojnë të njëjtat të drejta, kanë të njëjtat detyrime e trajtohen në mënyrë të barabartë.

## Neni 13

### Ndalimi i konkurrences

1. Personat e autorizuar për të përfaqësuar ose mbikqyrur shoqëritë tregtare nuk mund të mbajnë një pozicion drejtues apo të jenë të punësuar në shoqëri të tjera, që ushtrojnë veprimtari në të njëjtin sektor ekonomik me shoqërinë e parë. Gjithashtu, këta persona nuk mund të mbajnë statusin e tregtarit për të ushtruar veprimtari në këtë sektor.
2. Ndalimi i përmendur në pikën 1 të këtij neni të shfuqizohet nëpërmjet një autorizimi të posaçëm, të dhënë nga ortakët nga asambleja e përgjithshme me shumicë të kualifikuar.
3. Ndalimi i përmendur në pikën 1 të këtij neni, të mbetet në fuqi edhe pas humbjes së cilësive apo statusit të përmendur në të, për një periudhë një vit pas humbjes së kësaj cilësie.
4. Nëse ndonjëri prej personave të përmendur në pikën 1 të këtij neni shkel ndalimin e konkurrencës, shoqëria mund:
  - a) ta përjashtojë atë nga shoqëria apo ta shkarkojë nga detyra;
  - b) të kërkojë ndërprerjen e veprimtarisë konkurruese;
  - c) të ngrejë padi për shpërblimin e dëmit.
5. Shoqëria, si alternativë të ngritjes së padisë për shpërblimin e dëmit, mund t'i kërkojë secilit prej personave të përmendur në pikën 1 të këtij neni:
  - a) të pranojë se transaksionet e kryera për llogari të tij të kalohen për llogari të shoqërisë;
  - b) t'i transferojë shoqërisë të gjitha përfitimet që ka marrë nga kryerja e veprimeve për llogari të personave të tretë;
  - c) t'i transferojë shoqërisë të gjitha të drejtat e kreditë, që kanë rrjedhur nga kryerja e veprimeve për llogari të personave të tretë.
6. Padia për ushtrimin e të drejtave të shoqërisë ngrihet brenda 3 viteve nga data e kryerjes së shkeljes. Për ngritjen e padisë ndaj personave të sipërpërmendur zbatohen, gjithashtu, dispozitat e pikës 3 të nenit 10 të ligjit "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare".

## KREU IV

### KAPITALI THEMELTAR - PJESEMARRJA



#### **Neni 14**

##### **Kapitali i shoqërise dhe kuotat**

1. Kapitali i shoqërise ka vlerën 100 lekë i cili ndahet në 1 kuotë.
2. Kapitali i shoqërisë mund të zmadhohet, me vendim të Asamblesë së Përgjithshme. Në rast zmadhimi të kapitalit nëpërmjet shtimit të kuotave të reja, ortakët kanë të drejtën e përparësise në nënshkrim, proporcionalisht me shumën e kuotave të tyre, e drejtë nga e cila ata mund të heqin dorë.
3. Kapitali i shoqërisë, mund të zvogëlohet me vendim të Asamblesë së Përgjithshme. Zvogëlimi i kapitalit i prek të gjithë ortakët në të njëjtën masë ndaj kuotave të kapitalit që ata përfaqësojnë. Kapitali nuk mund të zvogëlohet nën kufirin minimal që lejon ligji "Per tregtarët dhe shoqëritë tregtare".

#### **Neni 15**

##### **Kontributet**


Kapitali i shoqërisë është i përbërë nga 1 kuotë dhe zotërohet nga ortaku i vetëm i shoqërisë, **Paul Tobiloba Olaoye** i cili zotëron 100 % të vlerës së kapitalit.

#### **Neni 16**

##### **Kalimi i kuotave të kapitalit**

1. Kuotat e kapitalit të shoqërise janë të kalueshme ndërmjet ortakëve dhe të kalueshme në rrugë trashëgimie. Trashëgimtari, paraardhësi ose pasardhësi, bëhen ortakë, nëpërmjet kalimit të kuotave të kapitalit.
2. Kuotat e kapitalit të shoqërise mund t'u kalohen personave të tretë që nuk bëjnë pjesë në shoqëri, me vendim të marrë me shumicën e ortakëve që përfaqësojnë të paktën  $\frac{3}{4}$  e pjeseve të kapitalit.
3. Në rast kur njeri apo disa nga ortakët dëshirojnë të kalojnë pjesërisht apo plotësisht, kuotat që ata zotërojnë në kapitalin e shoqërise tek të tretët, më parë duhet që oferta për shitje t'u bëhet ortakëve të tjerë të shoqërisë. Kur ortakët që gezojnë të drejtën e parablerjes kanë dyshime rreth cmimit të kuotave të ortakut që kërkon të kalojë ato, mund të drejtohen gjykatës që të caktojë një ekspert vlerësues. Ortaku që kërkon kalimin e kuotave tek të tretët duhet të lajmerohet në një afat sa më të shpejt, nëse brenda 4 javëve ortakut nuk i jepet një përgjigje atëherë prezumohet se ortakët e tjerë kanë rënë dakord që kuotat e tij mund të kalohen të tretëve.
4. Kalimi i kuotave do të bëhet me kontratë.
5. Kuotat mund të pjesëtohen për shkak të kalimit të tyre.

#### **Neni 17**




1. Ortaku mbulon personalisht humbjet e shoqërisë deri në pjesën e pashlyer të kontributeve të nënshkruara.
2. Kontributet e ortakëve përbëjnë kapitalin e regjistruar të shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar.

**KREU V**  
**ORGANET E SHOQERISE, KUORUMI DHE ZGJEDHJA E TYRE**

**Neni 18**

**Asambleja e pergjithshme**

1. Ortakët ka të drejtë të marrë pjesë në mbledhjet dhe vendimet e asamblesë se Pergjithshme, dhe ka të drejtën e votës në përpjestim me vlerën nominale të kuotës së tij në kapitalin që ai zotëron.
2. Ortaku mund të përfaqësohet në asamblenë e përgjithshme, në bazë të një autorizimi nga bashkëshorti ose nje person tjetër i zgjedhur prej tij, me kusht që këta të jenë autorizuar me prokurë (perjashtohet perfaqesimi i nje ortaku nga nje ortak tjetër apo administratori i shoqerise).
3. Administratorët e shoqërisë nuk mund të veprojnë si përfaqësues të ortakëve në asamblenë e përgjithshme.
4. Autorizimi mund të jepet vetëm për një mbledhje të Asamblesë së Përgjithshme, e cila përfshin edhe mbledhjet vijuese me të njëjtin rend dite.
5. Asambleja e Përgjithshme thirret nga administratorët, ekspertet kontabel të autorizuar, po qe se ka të tille, nga likuiduesit apo ortakët, të cilët përfaqësojnë të paktën 5 për qind të totalit të votave në asamblenë e përgjithshme të shoqërisë. Keta ortake mund t'i drejtojnë administratorëve një kërkesë me shkrim, përfshirë postën elektronike, për të thirrur asamblenë e përgjithshme dhe/ose përfshirjen e çështjeve të posaçme në rendin e ditës. Kërkesa duhet të përmbajë arsyet, objektivat dhe çështjet, për të cilat asambleja duhet të marrë një vendim. Nëse kërkesa refuzohet, këta ortakë kanë të drejtë ta thërrasin asamblenë dhe të caktojnë çështjet e rendit të ditës. Njoftimi do te behet me shkrese, ose nepermjet postes elektronike.
6. Njoftimi me shkresë apo me mesazh elektronik duhet të përmbajë vendin, datën, orën e mbledhjes dhe rendin e ditës e t'u dërgohet të gjithë ortakëve, jo më vonë se 7 ditë përpara datës së parashikuar për mbledhjen e asamblesë.
7. Nëse në kundërshtim me pikën 5 të këtij neni, asambleja e përgjithshme nuk thirret, ose çështja e kërkuar prej këtyre nuk futet në rendin e ditës, secili prej ortakëve, që kanë bërë kërkesën, ka të drejtë te procedoje sipas ligjit ne fuqi "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare":
8. Lajmërimi për mbledhjen e asamblesë se pergjithshme rregullisht bëhet nga administratorët.



9. Asambleja e Pergjithshme merr vendime per ceshtjet e meposhtme dhe eshte pergjegjese per to:
- a) Përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë; ndryshimet e statutit;
  - b) Emërimin dhe shkarkimin e administratorëve te shoqerise;
  - c) Emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
  - d) Përcaktimin e shpërblimeve për administratorët, likuiduesit dhe të ekspertëve kontabël te autorizuar;
  - e) Mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë se veprimtarisë;
  - f) Miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë. (pas marrjes dhe shqyrtimit te dokumentacionit perkates);
  - g) Zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit (pas marrjes dhe shqyrtimit te dokumentacionit perkates);
  - h) Pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
  - i) Përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë e në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
  - j) Riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
  - k) Miratimin e rregullave proceduriale të mbledhjeve të asamblesë;
  - l) Cështje të tjera të parashikuara nga ligji.
10. Të gjitha vendimet e marra nga Asambleja e Pergjithshme regjistrohen në një regjistër të vendimeve, të dhënat e të cilit nuk mund të ndryshohen ose të fshihen.
11. Duhet regjistruar në veçanti, por pa u kufizuar në to, vendimet për:
- a) Miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
  - b) Shpërndarjen e fitimeve vjetore dhe mbulimin e humbjeve;
  - c) Investime;
  - d) Vendimet për riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.
12. Vendimet e parregjistruara në regjistrin e vendimeve janë absolutisht të pavlefshme.
13. Sipas rëndësisë së vendimeve, mbledhja e asamblesë se pergjithshme mund të jetë e zakonshme ose e jashtëzakonshme.
14. Asambleja pergjithshme vendos me shumice te zakonshme për cështje të tilla si emërimi ose shkarkimi i administratorëve, ekspertëve kontabel të autorizuar dhe likuiduesve, miratimi i raporteve të administrimit dhe të kontrollit, miratimi i pasqyrave financiare vjetore. Asambleja mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë vote, që zotërojnë më shumë se 50% te kuotave dhe vendimet merren me me shume se gjysmen e votave te ortakeve pjesemarres.
15. Asambleja e pergjithshme vendos me shumice te kualifikuar për cështje të tilla si ndryshimet e statutit, zvogëlimi dhe zmadhimi i kapitalit themeltar, kalimi tek të tretët, zgjatja e kohës së veprimtarisë së shoqërisë apo likuidimi i saj, shndërimi i shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar në shoqëri të formave të tjera, ndarja e fitimeve si dhe cdo cështje


- tjetër që parashikohet në ligj. Marrja e vendimeve të vlefshme bëhet vetëm nëse ortaket që zoterojnë më shumë se 70% e kuotave janë të pranishëm, votojnë me shkrese apo mjete elektronike. Në këtë rast vendimet merren me  $\frac{3}{4}$  e votave të ortakeve pjesëmarrës.
16. Nëse asambleja e përgjithshme nuk mund të mbledhet për shkak të mungesës së kuorumit të përmendur në këtë pikë, të këtij neni, asambleja mbledhet përsëri jo më vonë se 30 ditë, me të njëjtin rend dite.

### **Neni 19** **Administrimi**

1. Shoqëria administrohet nga një ose më shumë administratorë të cilët janë persona fizikë të zgjedhur brenda bashkësisë së ortakëve apo dhe jashtë saj.
2. Asambleja e Përgjithshme emëron një ose më shumë persona fizikë si administratorë të shoqërisë. Afati i emërimit, është 5 vjet, me të drejtë ripërtëritjeje, me përjashtim të rastit të dorëheqjes ose të shkarkimit të parakohshëm para mbarimit të afatit. Shkarkimi i administratorëve nga organi kompetent mund të bëhet në çdo kohë.
3. Emërimi i administratorëve prodhon efekte pas regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit.
4. Administratorët emërohen dhe shkarkohen me vendim të asamblese së përgjithshme sipas parashikimit në këtë statut.

### **Neni 20** **Kompetencat e administratorëve**

1. Administratorët kanë të drejtë e detyrohen të:
  - a) kryejnë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikën tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme;
  - b) përfaqësojnë shoqërinë tregtare;
  - c) kujdesen për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
  - d) përgatisin dhe nënshkruajnë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përpara asamblesë së përgjithshme për miratim;
  - e) krijojnë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
  - f) kryejnë regjistrimet dhe dërgojnë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit;
  - g) raportojnë përpara asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;
  - h) kryejnë detyra të tjera të përcaktuara në ligj dhe në statut.



2. Administratorët janë të detyruar të thërrasin asamblenë e përgjithshme persa parashikon ky statut ose ligji.
3. Asambleja e përgjithshme mund të shkarkojë administratorin në çdo kohë me shumicë të zakonshme.

#### **Neni 21**

##### **Emerimi i pare i administratoreve**

Administrator i shoqërisë për periudhën 5-vjeçare do të jetë ortaku i vetëm z. **Paul Tobiloba Olaoye**.

#### **Neni 22**

##### **Eksperte kontabel te autorizuar**

1. Në rast nevojë si dhe kur kërkohet nga ligji, kontrolli financiar dhe aprovimi i llogarive vjetore kryhet nga një ekspert kontabel i autorizuar, i emëruar për dy vite financiare me mundësi rizgjedhjeje nga asambleja e përgjithshme me shumicë të zakonshme.
2. Shkarkimi i ekspertit kontabel të autorizuar vendoset në të njëjtat kushte si emërimi i tij, në rast se vërehen gabime, abuzime ose bëhet e pamundur kryerja e detyrës.

#### **KREU VI**

##### **VOTA**

#### **Neni 23**

##### **E drejta e votes**

Çdo ortak ka të drejta vote në përpjestim me vlerën nominale të kuotës së tij.

#### **Neni 24**

##### **E drejta per te kaluar rezolute**

Asambleja e përgjithshme mund të miratojë rezolute pa plotësuar kriteret e njoftimit në këtë statut apo në ligj. Që të miratohet një rezolute në mbledhjen e asamblese së përgjithshme duhet të jenë të pranishëm të gjithë ortaket personalisht dhe ta votojnë atë në mënyrë të unifikuar.

#### **KREU VII**

##### **MARREDHENIET FINANCIARE**

#### **Neni 25**

##### **Viti financiar**

Çdo vit financiar fillon nga 1 Janar dhe përfundon më 31 Dhjetor.

#### **Neni 26**

### **Bilanci vjetor**

1. Bilanci vjetor, inventari, raportet mbi operacionet e vitit financiar dhe raportet e vecanta të hartuara nga administratorët dhe eventualisht nga eksperti kontabël i autorizuar, miratohen nga asambleja e pergjithshme e zakonshme.
2. Miratimi i dokumentave mbi veprimtarine vjetore bëhet brenda një afati prej tre muajsh nga data e mbylljes së vitit financiar.
3. Gjuha qe perdoret ne hartimin e dokumentave vjetore eshte gjuha shqipe.

### **Neni 27**

#### **Dividentet**

Pas miratimit të llogarive vjetore dhe evidentimit të ekzistencës së fitimeve, asambleja e pergjithshme përcakton pjesën që u takon ortakëve në formën e dividendeve mbi fitimin ne raport me kuotat qe gjithsecili ka në shoqëri. Fitimi që do të ndahet ndërmjet ortakëve në raport me kuotat, përbëhet nga fitimi i vitit financiar të cilit i janë zbritur ose i janë shtuar respektivisht humbjet apo fitimet e mbartura nga vitet e mëparshme.

### **Neni 28**

#### **Marredheniet me bankat dhe institutet financiare**

Shoqëria ka te drejte te hap llogari likuiduese prane nje ose me shume bankave ose institucioneve financiare dhe te mund te kryeje veprime likuiduese prane bankave. Ne keto banka ose institute financiare si nenshkrim i pare do te depozitohet ai i administratorit te shoqerise, i cili duhet te nenshkruaj per te gjitha veprimet financiare ne emer e per llogari te shoqerise. Ai mund te autorizojë edhe persona te tjere brenda shoqerise.

### **Neni 29**

#### **Marredhenia me organet tatimore**

Veprimtaria ekonomike e shoqerise mbaron me 31 dhjetor te cdo viti. Administratori ose personat e caktuar prej tij jane te detyruar te paraqesin bilancin vjetor dhe deklarimin e te ardhurave, dhe ti depozitojne ato prane organit perkates te tatimeve.


## **KREU VIII**

### **NDRYSHIMI I STATUSIT TE SHOQERISE**

### **Neni 30**

#### **Prishja e shoqerise**

1. Shoqëria prishet me përfundimin e afatit të përcaktuar, kur kjo vendoset nga ortakët si dhe kur janë arsyet e parashikuara në ligj.
2. Shoqëria nuk prishet kur njëri prej ortakëve falimenton, bëhet i paaftë ose vdes, por vazhdon aktivitetin me ortakët e tjerë që kanë mbetur si dhe me trashëgimtarët e radhes së parë të ortakut që vdes.



**Neni 31**  
**Likuidimi**

1. Shoqëria hyn në procesin e likuidimit që në momentin e prishjes së saj. Për kryerjen e këtij procesi asambleja emëron një likuidues, i cili i paraqet asaj raportin e likuidimit dhe afatin e nevojshëm të përfundimit të tij.
2. Në fund të procesit të likuidimit asambleja vendos me vendimin e ortakëve që zotërojnë të paktën  $\frac{3}{4}$  e kuotave të kapitalit mbi bilancin përfundimtar e financiar, mbi aktin e rregullshmërisë së punës së likuiduesit dhe për mbylljen e procesit të likuidimit.
3. Pas pagimit të kreditorëve dhe shlyerjes së kuotave të kapitalit tek kontribuesit përkatës, likuiduesi ndan kapitalet e mbetura ndërmjet ortakëve proporcionalisht me pjesët që ato zotërojnë në kapitalin themeltar.

**Neni 32**  
**Shndërrimi i shoqërisë**

Shndërrimi i shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar në lloj tjetër shoqërie mund të kryhet vetëm me miratimin unanimit të ortakëve

**KREU IX**  
**DISPOZITA TË TJERA**

**Neni 33**  
**Mosmarreveshjet**

Të gjitha mosmarreveshjet që mund të lindin gjatë ekzistencës së shoqërisë ose gjatë periudhës së likuidimit midis ortakëve, ndërmjet Shoqërisë dhe ortakëve, do t'i paraqiten për zgjidhje Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

**Neni 34**

Për çështje që nuk janë parashikuar në këtë statut do të zbatohen dispozitat përkatëse të legjislacionit shqiptar në fuqi "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare".

Ky statut nënshkruhet nga themeluesi.

**THEMELUESIT E SHOQËRISË**  
**Ortaku i Vetëm dhe Administratori**  
**English Zone shpk**  
**Paul Tobiloba Olaoye**

Olaoye Paul Tobiloba  
